

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO - РЕПУБЛИКА КОСОВА		
KOMUNA E FERIZAJT - OPSTINA UROSEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
HISTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT - ИСТОРИЈА АДМИНИСТРАЦИЈЕ И СОБЛИЈА		
Ishje / Izlazne Data / Udal 21.06.2024		
Nr. Orgj / Org. jed 01	Nr. Prot / Br. Prot. 56	Nr. Strana 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.56
Data: 20.06.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit me Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) si dhe në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1.3 të Ligjit 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe në Statutin e Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datë 20.06.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2025-2033 TË KOMUNËS SË FERIZAJT

I

Me Planin Zhvillimor Komunal do të bëhet planifikimi i hapësirës, në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimit të tyre me nevojat, dhe mundësit reale, për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe planifikimit hapësinor, rregullimit të Komunës dhe ndërtimit të vendbanimeve të Ferizajt me qëllim të:

- Përcaktimit afatgjatë të synimeve për zhvillim ekonomik, shoqëror, hapësinor të Komunës së Ferizajt;
- Përcaktimit afatgjatë të vizionit, parimeve dhe prioriteteve të zhvillimit strategjik;
- Zhvillimit të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm, duke u bazuar në qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social e mjedisorë;
- Harmonizimit të planifikimit me zhvillimet dhe ndryshimet në hapësirë, Harmonizimit të planifikimit me ndryshimet në kornizën ligjore relevante, dhe shfrytëzimin racional dhe human të hapësirës, dhe resurseve, në pajtim me ligjet, parimet normat dhe standardet.

II

Kufiri i Territorit: Plani Zhvillimor Komunal do të hartohet për tërë territorin e Komunës së Ferizajt.

III

Subjekti përgjegjës për hartim do të përzgjedhet në përputhje me Ligjin Nr.03/L-241 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me asistencën e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, si dhe të gjitha drejtorive të Komunës së Ferizajt, shoqërisë civile, qytetarëve, dhe gjitha palëve tjera të interesit.

IV

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim: Kuvendi i Komunës së Ferizajt me buxhetin e komuës për Vitin 2024 dhe 2025 do të bëjë planifikimin e mjeteve të caktuara për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

V

Për këtë vendim do të kujdeset Kuvendi i Komunës si dhe Drejtoria e Urbanizmit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Khavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
HEJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Udhëzime: Izlaze: Date / Dana: 21/06/2024

Nr. Origjinalit / Br. Prot. / No. Originala: 01	Nr. Protokollit / Br. Prot. / No. Protokola: 57	Nr. Faqëve / Br. Strana: 1
---	---	----------------------------

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.57
Data: 20.06.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.04/L-074 për Sistem të adresave, si dhe në bazë të nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 20.06.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR: 01.NR.40 I DATËS 30.05.2024

I

Me këtë Vendim Plotësohet - Ndryshohet Vendimi me Nr: 01.Nr.40 i datës 30.05.2024 sa i përket këtyre anëtarëve:

Në vend të Agon Kamenicës si ekspert i Komunikacionit caktohet Ardita Fazliu;

Në vend të Blerona Hamitit e cila ishte zyrtare për futjen e të dhënave në ARIS, caktohet Enis Muharremi.

Po ashtu këtij komisioni i shtohet edhe Lindrit Rysha si ekspert i Gis-it.

II

Të gjitha pikat tjera të Vendimit me Nr. 01.Nr.40 i datës 30.05.2024 mbesin në fuqi.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës Ferizaj.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRATIVE I OSOBLJA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
Nëse / Izlaze: Date / Dana: 26/06/2024
Nr. Orgv / Org. jed: 01 Nr. Prot. / Br. Prot.: 58 Nr. Faqe / Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.58
Data: 20.06.2024

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d) neni 40, paragrafi 40.2 pika (c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) dhe nenit 25, paragrafit 2 pikës 2.3 së Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013 Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datën 20.06.2022, miraton:

**VENDIM
PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DRAFT KORNIZËS AFATMESME
BUXHETORE (KAB) 2025-2027**

I

Me këtë vendim miratohet në parim Draft Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Periudhën 2025-2027

II

Draft Korniza Afatmesme Buxhetore përmban kufijtë fillestar buxhetor të të gjitha burimeve të financimit, përfshirë grantet qeveritare dhe planifikimin e të hyrave vetanake për Vitin fiskal 2025, si dhe vlerësimet buxhetore për Vitin 2026 dhe 2027.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Draft Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Periudhën 2025-2027 ku paraqiten lista e projekteve në mënyrë të detajuar, prioritetet e tanishme dhe afatmesme.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesues i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Lloji i Aktit: Izlazni Date/Dana 26.06.2024
Nr. Orgv. Org. jed 01 Nr. Prot. Br. Prot. 59 Nr. F. shtete Br. Strana. 1
Ferizaj • Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.59
Data: 20.06.2024

Në bazë të nenit 6 pika 9 të Udhëzimit Administrativ 151/2020 të MASHT-it, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimorë dhe Aftësues në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohëshëm dhe në Statutin e Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 20.06.2024 mori këtë:

VENDIM

PËR EMËRTIMIN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËRZGJEDHËS NGA KUVENDI I KOMUNËS PËR ZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE TË SHKOLLAVE

I

MIRATOHET: Propozimi i Drejtorisë së Arsimit Ferizaj me Nr.272/24 i datës 13.06.2024 për emërtimin e dy anëtarëve të Komisionit për zgjedhës nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave.

II

Kuvendi i Komunës Ferizaj emëroi këta dy kandidat për anëtarë të komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave Ferizaj:

1. z. Bashkim Bytyqi – Kryetar i komisionit dhe
2. znj. Mendehie Lekaj Rexhaj – anëtare.
3. Anëtari i tretë emërohet nga MASHT-i.

III

Ky komision ka mandatë për një vit shkollorë nga momenti kur ky vendim hyn në fuqi

IV

Për këtë vendim do të kujdeset Kuvendi i Komunës si dhe Drejtoria e Arsimit Ferizaj.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi